



UNMIK



IPVQ

**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 1 paragrafi 1.3 pika (ç) të Rregullores 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë.

Duke pasur parasysh nevojat shumëdimensionale të rezidentëve të vendosur në Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare dhe në Institutin Special të Shtimes.

Me qëllim të plotësimit të nevojave intime personale të rezidentëve të vendosur në Institucionin e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare dhe në Institutin Special të Shtime, Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV nr. 05/2005
PËR
NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE REZIDENTËVE TË VENDOSUR NË
INSTITUCIONET E MPMS-së**

Neni 1

Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ

1.1 Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është që të rregullojë dhe përcaktojë shumën dhe rregullat e tjera procedurale të ndarjes së mjeteve financiare, për nevojat personale të rezidentëve në Institucionet e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare dhe në Institutin Special të Shtimes.

Neni 2

2.1. Përveç vendosjes dhe sigurimit të ushqimit dhe veshmbathjes rezidentëve të vendosur në Institucionet e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare dhe në Institutin Special të Shtimes, për plotësimin e nevojave intime personale, çdo muaj ju ndahen nga një shumë e mjeteve financiare.

Neni 3

3.1 Shuma e mjeteve financiare për një muaj që ju ndahet rezidentëve të Institucioneve të MPMS-së për plotësimin e nevojave intime personale, është 10 €(euro) për një rezident.

Neni 4

4.1 Këto mjete financiare që ju ndahen rezidentëve për plotësimin e nevojave personale duhet t'ju shërbejnë për blerjen e cigareve, kafesë, sheqerit, lëngjeve, pajisjeve higjienike, pajisjeve kozmetike dhe artikujve të tjerë sipas dëshirës së vet rezidentit.

Neni 5

5.1 Mjetet financiare për këtë destinim, sigurohen nga buxheti i Departamentit të Mirëqenies Sociale, përkatësisht nga Divizioni për Përkujdesje Institucionale të këtij Departamenti.

Neni 6

6.1 Varësisht nga mundësitë buxhetore, shuma e mjeteve financiare që ju ndahet rezidentëve të këtyre institucioneve mund të ndryshojë në aspektin pozitiv duke u rritur shuma e kështit mujor për një rezident.

Neni 7

7.1 Ndryshimi i shumës së mjeteve financiare të kështit mujor për një rezident, duhet të iniciohet nga Drejtori i DMS-së, ndërsa për këtë ndryshim vendos Ministri i MPMS-së duke nxjerrë vendim të veçantë, apo duke bërë ndryshimet dhe plotësimet e këtij Udhëzimi Administrativ.

Neni 8

8.1 Për realizimin e këtij Udhëzimi Administrativ, përkujdeset stafi menaxhues i Divizionit të përkujdesjes institucionale të DMS-së, Drejtorët e Institucioneve dhe Divizioni i financave të Departamentit të Administratës Qendrore të MPMS-së.

Neni 9

Hyrja në fuqi

9.1 Ky Udhëzim Administrativ hynë në fuqi, ditën e nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa do të aplikohet nga 01.05.2005.

Prishtinë, mars 2005

**Ministri i MPMS-së
Ibrahim Selmanaj**
